



ditëve pune, nga data e njoftimit, i cili merr vendim brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike, nga data e paraqitjes së ankesës.

12. Ministri, pas përfundimit të afatit të ankimit, negociacion dhe nënshkruan marrëveshjen me ofertuesin fitues, e cila përmban, ndërmyet të tjerash, termat kryesorë të ofrimit të shërbimit.

13. Efektet financiare për vitin 2020 do të mbulohen nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit.

14. Ngarkohet ministria përgjegjëse për financat për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 202, datë 5.3.2020

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË
RINDËRTIMIT, MIRATUAR NË
BUXHETIN E VITIT 2020, PËR
FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË
BANESAVE INDIVIDUALE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nënndarjes “I”, të shkronjës “b”, të nenit 13, dhe të nenit 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2020, në masën 8 736 419 145 (tetë miliardë e shtatëqind e tridhjetë e gjashtë milionë e katërqind e nëntëmbëdhjetë mijë e njëqind e dyzet e pesë) lekë, për financimin e rindërtimit të banesave individuale, sipas projekteve model të miratuara.

2. Fondi i përcaktuar në pikën 1 t'u kalojë njësisë zbatuese, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në buxhetin e miratuar për vitin 2020, në zërin “Shpenzime kapitale me financim të brendshëm” të programit 06210 “Programe zhvillimi”, i shtohet fondi prej 6 528 564 252 (gjashtë miliardë e pesëqind e njëzet e tetë milionë e pesëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e dyqind e pesëdhjetë e dy) lekësh.

b) Bashkisë Tiranë i transferohet fondi prej 2 207 854 893 (dy miliardë e dyqind e shtatë milionë e tetëqind e pesëdhjetë e katër mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e tre) lekësh, në formën e transfertës së pakushtëzuar.

3. Fondet e mbetura të papërdorura, pas përfundimit të procedurave të prokurimit në zbatim të këtij vendimi, kthehen në zërin “Fondi për rindërtim” të buxhetit të shtetit.

4. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama